



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Dëgjimi i pëgjithshëm publik mbajtur më 20.7.2026, i cili filloi në orën 14:00

Të pranishmë ishin: - Valbona Makolli, drejtore në drejtorinë e Financave, Driton Bardheci, drejtor në drejtorinë e Administratës, Jeta Rafuna, drejtore në drejtorinë e Bujqësisë, Donat Gashi, drejtor në drejtorinë e Rinisë, Isah Mustafa, drejtor në drejtorinë e Kulturës, Adelina Sahiti, drejtore në drejtorinë e Mirëqenies Sociale, Leutrim Retkoceri, drejtor në drejtorinë e Shërbimeve Publike, Granit Geci, drejtor në drejtorinë e Sportit, Rrezarta Aliu, drejtore në drejtorinë e Turizmit dhe shefi i Investimeve Kapitale, Liridon Shahini.

Osman Bllaca: - Osman Bllaca hapi takimin publik për planifikimin e buxhetit të vitit 2027. Informoi se debatet publike do të zhvillohen gjatë gjithë javës, çdo ditë në orën 14:00. Sqaroi se takimi i asaj dite ishte i fokusuar në identifikimin e kërkesave të sportistëve, të rinjve, organizatave joqeveritare (OJQ) dhe qytetarëve për projekte dhe subvencione në buxhetin e vitit 2027. Kërkoi nga pjesëmarrësit të regjistroheshin në listën e pjesëmarrjes, sipas procedurave të përcaktuara. Njoftoi se secili pjesëmarrës do të prezantohej dhe do të kishte deri në pesë minuta për të paraqitur kërkesat dhe propozimet e tij për buxhetin. Ftoi pjesëmarrësit të marrin fjalën sipas radhës, duke filluar me Enver Redenicën.

Enver Redenica: - u prezantua si asamblist në Kuvendin Komunal, por theksoi se në takim po merrte pjesë si qytetar i lagjes Sofali dhe ish-kryetar i këshillit lokal. Ai shprehu qëndrimin se takimet për planifikimin e buxhetit shërbejnë më shumë për përmbushjen e obligimeve ligjore sesa për adresimin e problemeve të qytetarëve. Kujtoi se gjatë kohës sa ishte kryetar i këshillit lokal, lagja Sofali mori pjesë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe fitoi një grant prej **200 mijë eurosh**. Sqaroi se më **5 korrik 2024** u organizua një takim me qytetarët, ku u përcaktuan tri prioritetet: ndërtimi i **dy këndeve të lojërave për fëmijë** dhe **një stadiumi**. Theksoi se projektet u votuan në gusht 2024 dhe u caktuan edhe lokacionet për realizimin e tyre. Ngriti shqetësimin se, pas dy vitesh, projektet ende nuk janë realizuar dhe kërkoi sqarime se ku kanë përfunduar mjetet e grantit. Shprehu gatishmëri për të bashkëpunuar në mënyrë që projektet e miratuara të realizohen,

duke theksuar se ato janë mjete të taksapaguesve dhe nuk duhet të shtyhen apo të manipulohen nga një vit buxhetor në tjetrin.

Gëzim Sveçla: - kërkoi informacione mbi buxhetin e planifikuar për rininë, sportin dhe organizatat joqeveritare për vitin 2027. Ai theksoi se njohja e shumës së buxhetit është e nevojshme për të paraqitur propozime reale dhe të zbatueshme. Vlerësoi se, nëse buxheti është i kufizuar, propozimet mund të mbeten vetëm dëshira. Njoftoi se, pas marrjes së këtyre informacioneve, do të paraqiste propozime konkrete për të tri fushat.

Valbona Makolli - drejtoreshë e Financave: - falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen. Ajo sqaroi se Komuna e Prishtinës ende nuk e ka pranuar qarkoren e dytë nga Ministria e Financave, prandaj nuk ka në dispozicion kufijtë përfundimtarë buxhetorë. Sipas qarkores së parë, buxheti i përgjithshëm i planifikuar për Komunën e Prishtinës për vitin 2027 është **161.5 milionë euro**, prej të cilave **54.8 milionë euro** janë të dedikuara për paga dhe mëditje nga granti qeveritar. Theksoi se pritet që Ministria e Financave ta dërgojë qarkoren e dytë deri në fund të javës, ndonëse sipas afateve ligjore ajo është dashur të publikohet më 15 korrik, sqaroi se Komuna i ka nisur me kohë thirrjet për dëgjimet buxhetore, duke pritur që qarkorja e dytë të ishte pranuar sipas afatit. Për shkak të mungesës së qarkores së dytë, ajo theksoi se nuk ka qenë e mundur të prezantohen kufijtë buxhetorë për secilën kategori, ndërsa buxheti total mbetet ai i parashikuar në qarkoren e parë.

Gëzim Sveçla: - popozoi që në buxhetin e vitit 2027 të parashihet ndërtimi i së paku dy fushave të futbollit për shkollat e futbollit në Prishtinë. Ai theksoi se mungesa e infrastrukturës sportive, veçanërisht e fushave të futbollit, është një nga sfidat kryesore me të cilat përballen shkollat e futbollit në kryeqytet. Propozoi që, varësisht nga mundësitë buxhetore, projekti të realizohet brenda vitit 2027 ose më së largu brenda një periudhë dyvjeçare. Sipas tij, fushat e ndërtuara duhet t'u jepen në menaxhim shkollave të futbollit, me orare të përcaktuara për zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Ai shtoi se përfituese duhet të jenë shkollat e licencuara nga Federata dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara, duke theksuar se krijimi i infrastrukturës është prioriteti kryesor.

Veton Kasapolli : - ngriti shqetësimin për tarifat që trajnerët dhe klubet sportive paguajnë për shfrytëzimin e hapësirave në shkollat publike, duke theksuar se kjo kosto bartet te prindërit. Ai vlerësoi se aktivitetet sportive për fëmijët duhet të mbështeten më shumë nga komuna, në mënyrë që pjesëmarrja të jetë më e përbalueshme për të gjitha familjet. Gjithashtu propozoi krijimin e një programi komunal për mbështetjen financiare të trajnerëve dhe klubeve sportive që zhvillojnë aktivitete në objektet publike, me qëllim uljen e kostove për prindërit. Përgëzoi komunën për mosshndërrimin e oborreve të shkollave në parkingje, duke theksuar rëndësinë e tyre si hapësira për aktivitete sportive. Kërkoi investime në infrastrukturën sportive të Shkollës “Naim Frashëri”, përfshirë renovimin e parketit dhe përmirësimin e pajisjeve sportive, veçanërisht vendosjen e koshave cilësorë të basketbollit.

Fatmir Zhdrella: - si përfaqësues i fushës së sportit dhe arsimit, sqaroi se të ardhurat nga pagesat për shfrytëzimin e sallave sportive rikthehen në shkollën përkatëse dhe përdoren për mirëmbajtjen e saj. Ai theksoi se megjithëse e kupton arsyen e vendosjes së tarifave, personalisht mbështet heqjen e tyre, duke argumentuar se, përfshirja e më shumë fëmijëve në sport ndikon pozitivisht në zhvillimin e tyre dhe i largon nga rruga, propozoi që fushat sportive me asfalt në oborret e shkollave të transformohen në fusha me bar sintetik, duke e konsideruar këtë një investim me ndikim të madh, si shembull, ai përmendi fushën në Shkollën “Gjergj Fishta”, ku pas vendosjes së barit sintetik numri i fëmijëve që e përdorin është rritur ndjeshëm. Rekomandoi që investime të ngjashme të realizohen edhe në shkolla të tjera, për të përmirësuar infrastrukturën sportive dhe për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete sportive.

Erza Ramadani : - përfaqësuese e Fondacionit për të Drejtat e Kafshëve, kërkoi informacione mbi buxhetin e planifikuar për vitin 2027, për menaxhimin e popullsisë së qenve endacakë. Ajo ngriti shqetësime lidhur me skemën e kompensimit prej 50 euro në muaj për personat që adoptojnë qen, duke vlerësuar se mungon transparenca për mënyrën e shfrytëzimit të fondeve publike dhe trajtimin e kafshëve, kërkoi sqarime nëse edhe për vitin 2027 planifikohet vazhdimi i kësaj skeme dhe si parashihet të përdoret buxheti në këtë fushë. Theksoi nevojën për transparencë mbi aktivitetet dhe masat që do të financohen, në mënyrë që organizatat dhe qytetarët të mund të japin propozime të qëndrueshme dhe afatgjata. Vlerësoi se fondet publike duhet të orientohen drejt zgjidhjeve efektive dhe të menaxhohen në mënyrë të përgjegjshme.

Valbona Makolli: - sqaroi se qëllimi i dëgjimit publik është mbledhja e kërkesave dhe propozimeve të qytetarëve sipas fushave përkatëse, pasi buxheti për vitin 2027 ende nuk është planifikuar përfundimisht. Ajo theksoi se, sipas obligimeve ligjore, Komuna është e detyruar t'i dëgjojë qytetarët dhe të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së kërkesave të tyre në planifikimin buxhetor. Lidhur me menaxhimin e qenve endacakë, ajo sqaroi se qytetarët dhe organizatat kanë të drejtë të kërkojnë qasje në dokumentet dhe raportet përkatëse, ndërsa vlerësimi i rasteve bëhet nga komisioni kompetent. Theksoi se të gjitha kërkesat e paraqitura në dëgjim publik do të regjistrohen, do të publikohen (duke mbrojtur të dhënat personale) dhe do të shqyrtohen për përfshirje në buxhet, në varësi të mundësive financiare. Ajo njoftoi se programi për menaxhimin e qenve endacakë pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2027, ndërsa vlera e buxhetit për këtë fushë do të përcaktohet pasi komuna të pranojë kufijtë buxhetorë nga Ministria e Financave. Shtoi se, sapo të pranohen kufijtë buxhetorë, ato do të publikohen dhe komuna do të vazhdojë komunikimin me qytetarët dhe palët e interesuara.

Leutrim Retkoceri - drejtorë i Shërbimeve Publike: - sqaroi se në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve është paraparë një kod për investime kapitale për ndërhyrje në qendrat ekzistuese për menaxhimin e qenve dhe mundësinë e zgjerimit apo ndërtimit të një qendre të re. Ai theksoi se për vitin e parë janë planifikuar rreth **350 mijë euro**, me vazhdim të investimeve edhe gjatë tre viteve pasuese, për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ai bëri të ditur se çështja do të analizohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave, me qëllim që të sigurohet një ndarje më serioze dhe e qëndrueshme buxhetore për trajtimin e qenve. Sqaroi se në Komunën e Prishtinës vlerësohet të ketë mbi **5 mijë qen**, ndërsa deri tani rreth **2 mijë qen** janë trajtuar ose janë menaxhuar përmes masave ekzistuese. Theksoi se mbetet sfida trajtimi i plotë i popullsisë së qenve dhe se nevojitet një strategji gjithëpërfshirëse në bashkëpunim me qytetarët, organizatat dhe institucionet për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme.

Isa Rexha- kryetar i Këshillave lokale të Barilevës dhe Drenovcit: - ngriti shqetësimin për mosrealizimin e projektit të fushës së sportit në Barilevë. Ai tha se në vitin 2024 ishin ndarë 1 milion euro për sport, të shpërndara në pesë këshilla lokale, ku përfshihej edhe Barileva. Sipas tij, janë mbajtur takime dhe është përcaktuar lokacioni për projektin, por pagesat nuk janë realizuar. Ai theksoi se projekti është diskutuar dhe miratuar në Kuvendin Komunal, por ende nuk është zbatuar. Shprehu pakënaqësi për vonesat dhe pretendoi se një person po e pengon realizimin e projektit, pavarësisht vendimeve të institucioneve komunale. Gjithashtu, ai tha se ka kërkuar disa herë takim me drejtorin e pronës, por pa marrë përgjigje konkrete. Në fund, ai kërkoi sqarim se kur do të ndahet hapësira për stadiumin dhe kur do të zbatohet vendimi i miratuar nga Kuvendi Komunal.

Osman Billaca: - pyet për kërkesat me shkrim. A janë të gjitha për buxhetin apo ke edhe kërkesa tjera për 2027 apo janë edhe për 2026?

Isa Rexha: - theksoi se të gjitha kërkesat i ka dërguar me email drejtorëve përkatës dhe Drejtorisë së Financave. Ai ngriti shqetësimin për mungesën e qartësisë rreth financimit të çerdhes në Barilevë, duke kërkuar sqarime për planifikimin buxhetor. Gjithashtu, ai vuri në dukje problemet me ndriçimin publik, duke thënë se gjysma e fshatit është pa ndriçim, ndërsa një pjesë e dritave ekzistuese nuk funksionojnë, pavarësisht raportimeve të vazhdueshme. Rexha tha se rreth 32 kilometra rrugë në Barilevë janë ende të pashtuara dhe kërkoi të paktën furnizimin me zhavorr për rrugët më problematike. Ai shprehu shqetësim edhe për vendosjen e serrave në prona shtetërore përmes projekteve komunale. Në fund, ai theksoi se kërkesat e Barilevës dhe Drenovcit kanë mbetur të njëjta nga viti 2024 deri në vitin 2026, pa u realizuar, pavarësisht pjesëmarrjes së tij të vazhdueshme në takimet me komunën.

Emin Bajrami- trajner i shkollës së futbollit Hajvalia: - shprehu shqetësimin e tij në një dëgjim publik lidhur me trajtimin e pabarabartë të klubit. Ai theksoi se shkolla ka rreth 200 futbollistë dhe fillimisht kishte marrë leje nga Komuna e Prishtinës për stërvitje tri herë në javë në orarin 17:00–20:00. Sipas tij, ky orar u ndryshua nga menaxhmenti i stadiumit “Prishtina e Re”, duke u caktuar stërvitje në orët 13:00–15:00, kur temperaturat janë shumë të larta. Si pasojë, tre fëmijë përfunduan në spital për shkak të vapës, ndërsa shumë prindër shprehën pakënaqësi. Bajrami ngriti pyetjen nëse stadiumi është ndërtuar për komunitetin apo vetëm për një klub, duke e cilësuar këtë situatë si diskriminuese. Ai kujtoi kontributin e tij dhe të shumë sportistëve për futbollin e Kosovës dhe kërkoi nga Komuna e Prishtinës dhe drejtori i sportit që të gjejnë një zgjidhje të drejtë. Në fund, ai theksoi se futboli është profesioni i tij dhe se fëmijët meritojnë kushte të sigurta për stërvitje.

Gresa Stublla- menaxhere e programit në organizatën Handikos: - prezantoi punën e organizatës, e cila prej vitit 1983 ofron shërbime sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara. Ajo theksoi se Handikos, pavarësisht përvojës mbi 40-vjeçare, vazhdon të përballlet me vështirësi financiare, pasi mbështetet tërësisht në projekte dhe grante. Stublla shprehu pakënaqësi për nivelin e ulët të mbështetjes financiare nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, megjithëse ishte premtuar rritje e fondeve. Ajo ngriti shqetësimin se Handikos ofron shërbime për më shumë se 25 diagnoza neurologjike, por trajtohet në mënyrë të ngjashme me organizata që mbulojnë vetëm një fushë të kufizuar. Gjithashtu, ajo përmendi se gjatë vitit të kaluar gjashtë fëmijë humbën jetën si pasojë e komplikimeve të lidhura me aftësinë e kufizuar. Në fund, kërkoi sqarime mbi mënyrën e vlerësimit të granteve dhe propozoi rritjen e fondeve, si dhe krijimin e një linje të veçantë buxhetore për organizatat që ofrojnë shërbime sociale.

Ema Koxha- studente nga Prishtina: - paraqet kërkesat e të rinjve të mbledhura përmes trajnimeve dhe sondazheve për buxhetin komunal. Ajo kërkon më shumë mundësi për aftësim profesional, trajnime, praktika dhe një platformë digjitale që informon të rinjtë për aktivitete, punësim dhe mundësi zhvillimi. Gjithashtu propozon rritjen e mbështetjes financiare për kurse, bursa dhe rishikimin e kritereve për përfitimin e tyre. Ndër prioritetet janë krijimi i qendrave rinore të qasshme për të gjithë, përmirësimi i sigurisë dhe ndriçimit publik, vendosja e koshave për mbeturina dhe riciklim, ofrimi i Wi-Fi falas në hapësira publike dhe krijimi i një platforme për raportimin e problemeve në lagje, me qëllim forcimin e komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve lokale.

Naser Krasniqi- përfaqësues i Klubit të Volejbollit të Femrave Prishtina 75: - kërkon rritjen e mbështetjes financiare për sportin e femrave dhe ndarjen e subvencioneve në baza meritore, duke marrë parasysh historinë, sukseset dhe masivitetin e klubeve. Ai ngre shqetësime për mungesën e termineve të përshtatshme për stërvitje në Pallatin e Rinisë dhe kërkon që shkollat të hapin palestrat për klubet elitare sportive. Gjithashtu, kërkon sqarime për fondet dhe subvencionet e sportit për vitin 2026.

Në pjesën e dytë të fjalës së tij, ai thekson rëndësinë e mbështetjes së aktiviteteve kulturore dhe ansambleve artistike, duke propozuar rritjen e subvencioneve, organizimin e festivaleve të reja kulturore dhe krijimin e një shtëpie të kulturës për ansamblet në Prishtinë. Ai nënvizon edhe nevojën për ruajtjen e traditës dhe përfshirjen e më shumë të rinjve, veçanërisht djemve, në aktivitetet kulturore dhe artistike.

Bejtullah Abdullahu - nga lagjia Bregu i Diellit: - tha se organizimin e debateve dhe konsultimeve publike për sportin. Ai ngriti si shqetësim mungesën e një piste të standardizuar të atletikës në Prishtinë. Sipas tij, kryeqyteti është i vetmi në Evropë që nuk posedon një infrastrukturë të tillë sportive. Ai theksoi se pista nuk do t'u shërbente vetëm atletëve, por edhe sportistëve të tjerë, Policisë së Kosovës, FSK-së, zjarrfikësve dhe qytetarëve. Sipas tij, ndërtimi i saj do të ishte një investim me përfitime afatgjata për gjithë komunitetin. Abdullahu propozoi që të shfrytëzohet një hapësirë pranë Rrugës B, ku sipas tij ka territor të pashfrytëzuar nga investimet publike. Ai vlerësoi se rreth 2 hektarë tokë do të ishin të mjaftueshëm për realizimin e projektit. Gjithashtu, ai përmendi se kostoja e ndërtimit do të ishte rreth 1 milion euro. Në fund, ai kërkoi nga drejtori i sportit të sqarojë nëse një projekt i tillë është planifikuar në buxhetin dhe planet e komunës.

Albian Ismaili - përfaqësues i Oltarimor Club Prishtina: - u nderlidh në debat dhe prezantoi punën e klubit të veturave historike, i themeluar katër vite më parë. Klubi numëron rreth 25 anëtarë me automjete klasike të restauruara dhe funksionale. Ai theksoi se restaurimi i veturave historike përfaqëson ruajtjen e trashëgimisë kulturore, jo vetëm një hobi. Klubi është ndër pesë themeluesit e Federatës së Klubeve të Automjeteve Historike të Kosovës dhe merr pjesë në aktivitete brenda dhe jashtë vendit. Megjithatë, ndryshe nga qytetet e tjera, Prishtina ende nuk ka organizuar një festival të tillë. Ismaili kërkoi që Komuna të ndajë buxhet për organizimin e një aktiviteti vjetor në kryeqytet. Ai propozoi që në qendër të Prishtinës të organizohet një ekspozitë dhe defilim me automjete historike nga Kosova, Shqipëria dhe rajoni. Sipas tij, një ngjarje e tillë do ta pasuronte jetën kulturore dhe turistike të qytetit. Ai theksoi se përpjekjet e deritanishme për bashkëpunim me institucionet nuk kanë marrë përgjigje. Në fund, kërkoi që klubi të mbështetet dhe të ketë mundësinë të kontribuojë me të paktën një aktivitet kulturor çdo vit në Prishtinë.

Gresa Berisha- nga platforma Civikos: - theksoi rëndësinë e rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen komunale përmes mjeteve digjitale. Ajo propozoi krijimin e një platforme online ku qytetarët mund të raportojnë probleme, të paraqesin kërkesa dhe të ndjekin trajtimin e tyre. Sipas saj, pjesëmarrja vetëm përmes takimeve fizike kufizon përfshirjen e shumë qytetarëve, veçanërisht atyre që nuk mund të marrin pjesë gjatë orarit të punës. Berisha vlerësoi se informacioni për konsultimet publike nuk është mjaftueshëm i qasshëm dhe duhet të promovohet më mirë. Ajo sugjeroi që komuna të ketë një kanal të dedikuar dhe të centralizuar për dëgjimet publike dhe komunikimin me qytetarët. Gjithashtu, kërkoi që qytetarët të marrin përgjigje të qarta për komentet dhe propozimet e tyre, duke ditur se cilat janë pranuar ose refuzuar. Sipas saj, një sistem i tillë do të rriste transparencën, besimin e qytetarëve dhe angazhimin e tyre në proceset lokale. Në fund, ajo theksoi se një platformë e unifikuar do ta promovonte më mirë edhe punën e komunës dhe do ta afronte institucionin më shumë me qytetarët.

Burim Berisha - qytetar i Prishtinës: - dhe prind i notueses Olta Berisha, tha dhe e ngriti çështjen e mbështetjes për sportistët individualë. Ai theksoi se Olta është një nga notueset më të suksesshme në Kosovë dhe fituese e Maratonës Ndërkombëtare të Batllavës në garën 5 km. Sipas tij, ajo ka thyer rekorde shtetërore dhe ka përfaqësuar Kosovën me sukses në gara ndërkombëtare në Çeki, Poloni dhe Kroaci. Ai përmendi se sportistja ka arritur rezultate të larta, duke fituar vende të para dhe të treta në këto gara. Berisha pyeti Drejtorinë e Sportit nëse është planifikuar ndonjë formë subvencionimi ose mbështetjeje financiare për sportistët elitare individualë, përveç mbështetjes që u jepet klubeve sportive. Ai kërkoi informacione mbi mundësitë që këta sportistë të përkrahen nga komuna në vitet e ardhshme, në mënyrë që të vazhdojnë përfaqësimin e suksesshëm të Prishtinës dhe Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Alberita Hylaj- përfaqësuese e Hendikos: - dhe familjare e një personi me aftësi të kufizuara, kërkoi rritjen e mbështetjes financiare për organizatën në planifikimin buxhetor për vitin 2027. Ajo theksoi se Hendikos ishte përballur dy vite më parë me vështirësi serioze financiare, të cilat rrezikuan mbylljen e shërbimeve. Sipas saj, fëmijët dhe të rriturit që përfitojnë nga këto shërbime, si dhe familjet e tyre, janë qytetarë dhe tatimpagues të Prishtinës, prandaj meritojnë mbështetje të qëndrueshme. Hylaj kërkoi që financimi të mos kufizohet vetëm në subvencione të vogla, por të sigurohen mjete të mjaftueshme për funksionim dinjitoz të shërbimeve. Ajo ngriti shqetësimin edhe për mungesën e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet kulturore. Gjithashtu, theksoi se organizata nuk kishte marrë informacione për projektet e aplikuara në Drejtorinë e Kulturës dhe kërkoi më shumë transparencë dhe përgjigje për aplikimet. Në fund, ajo bëri thirrje që institucionet komunale të ofrojnë mbështetje dhe trajtim dinjitoz për këtë kategori qytetarësh.

Arsim Sfishta- drejtor i Ansamblit “Bajram Curri” në Prishtinë: - prezantoi historikun dhe sfidat e këtij institucioni kulturor të themeluar në vitin 1965. Ai theksoi se nga ky ansambël kanë dalë mbi 5.000 artistë dhe shumë emra të njohur të kulturës dhe estradës së Kosovës. Ansambli ka përfaqësuar për dekada Komunën e Prishtinës dhe ka kontribuar në ruajtjen e folklorit, dramës dhe traditës popullore. Para tre vitesh është shpallur ansambël i mbrojtur i trashëgimisë kulturore shpirtërore. Sfishta ngriti shqetësimin për mungesën e një hapësire të qëndrueshme për ushtrime dhe zhvillim të aktiviteteve, pasi pas luftës ansambli ka lëvizur nga një objekt në tjetrin. Aktualisht ansambli ka mbi 100 anëtarë dhe së fundmi janë formuar edhe baleti dhe orkestra e qytetit. Ai kërkoi që Ansambli “Bajram Curri” të trajtohet njësoj si institucionet e tjera kulturore komunale. Në veçanti, kërkoi që të mos mbështetet vetëm përmes subvencioneve të vogla, por të ketë status dhe përkrahje të qëndrueshme si ansambël komunal i Prishtinës.

Abdullah Gashi- përfaqësues i klubit të bilardos “Shooter”: - diskutoi dhe prezantoi aktivitetin dhe sfidat me të cilat përballlet klubi. Ai theksoi se klubi ka rreth 70 anëtarë, ku shumica janë juniorë, ndërsa rreth 20% janë femra dhe pjesa tjetër lojtarë profesionistë. Sipas tij, klubi ka një numër të konsiderueshëm sportistësh aktivë dhe synon zhvillimin e mëtejshëm të bilardos në Prishtinë. Gashi ngriti si problem kryesor mungesën e organizimeve dhe turneve të tjera përveç garave të organizuara nga federata. Ai tha se lojtarët kanë kërkesa të vazhdueshme për më shumë aktivitete dhe mundësi konkurrimi. Për këtë arsye, kërkoi mbështetje dhe bashkëpunim nga institucionet për organizimin e aktiviteteve të reja sportive dhe avancimin e klubit të bilardos “Shooter”.

Enver Redenica - asambleist: - kërkoi sqarime nga drejtoria për realizimin e projekteve sportive të financuara përmes granteve. Ai ngriti çështjen e mjeteve prej 200.000 eurosh të alokuara për ndërtimin e dy këndeve të lojërave dhe stadiumit të qytetit në Sofali. Redenica kërkoi të dijë se çfarë është bërë me këto mjete deri më tani dhe pse projektet ende nuk janë realizuar. Ai iu drejtua drejtoreshës dhe drejtorit të sportit për një përgjigje konkrete lidhur me statusin e këtyre investimeve. Gjithashtu, pyeti nëse këto projekte do të mund të përfshihen në planifikimin buxhetor për vitin 2027. Ai theksoi se këto mjete ishin siguruar përmes procesit të buxhetimit me pjesëmarrje në vitin 2024 dhe kërkoi transparencë për shfrytëzimin e tyre.

Osman Bllaca: - kërkoi që klubet dhe organizatat sportive të planifikojnë me kohë kërkesat e tyre për buxhet dhe të respektojnë procedurat ligjore të aplikimit. Ai theksoi se subvencionimi përmes Kuvendit Komunal nuk është forma e duhur dhe se kjo çështje është evidentuar edhe nga auditorët si problem. Bllaca kërkoi që institucionet të përdorin thirrje dhe procedura të rregullta për ndarjen e mjeteve publike. Ai ngriti edhe nevojën për ndryshimin e rregullores për shpërblimin dhe mbështetjen e sportistëve e klubeve sipas kategorive dhe rezultateve të arritura. Sipas tij, shpërblimet e përcaktuara paraprakisht do ta lehtësonin procesin dhe do të siguronin trajtim më të drejtë për sportistët. Ai përmendi nevojën që klubet përfituese të dorëzojnë raportet narrative dhe

financiare për përdorimin e subvencioneve. Bllaca paralajmëroi se mosraportimi i mjeteve publike duhet të trajtohet nga institucionet përgjegjëse. Në fund, kërkoi më shumë përgjegjësi nga klubet dhe respektim të rregullave për aplikime dhe financim publik.

Granit Geci - drejtor i Sportit: - Theksoi se çështja e stadionit të Barilevës mbetet prioritet dhe ftoi z. Rexha në takim për të gjetur një zgjidhje. Tha se do të vazhdojë komunikimin me menaxhmentin e Shkollës së Futbollit Hajvalia për zgjidhjen e problemit të termineve, duke kërkuar mirëkuptim nga të gjitha palët. Pranoi se sistemi aktual i subvencioneve nuk ka qenë i drejtë dhe paralajmëroi ndryshimin e rregullores me kategorizim të klubeve. Njoftoi se synohet rritja e buxhetit për subvencione në vitin e ardhshëm. Theksoi se do të mbështeten edhe sportistët individualë, të cilët deri më tani kanë mbetur jashtë skemës së subvencioneve. Shpjegoi se këtë vit ka vështirësi buxhetore, pasi fondet e planifikuara janë shfrytëzuar paraprakisht, por do të tentohet të hapet të paktën një thirrje për aktivitete. Tha se synimi është që nga viti i ardhshëm Komuna e Prishtinës të publikojë dy thirrje për subvencione në vit. Njoftoi se projekti për shtegun e atletikës është përfshirë në kornizën afatmesme buxhetore. Shprehu gatishmëri për të mbështetur organizimin e ngjarjeve sportive dhe ftoi klubet për bashkëpunim me Drejtorinë e Sportit. Pranoi nevojën për ndërtimin e një terreni sportiv dhe këndi të lodrave në Sofali dhe tha se do të tentojë ta përfshijë projektin në planifikimin e ardhshëm buxhetor.

Valbona Makolli - drejtoreshë e Financave: - tha se do të shqyrtohen mundësitë buxhetore për përfshirjen e kërkesave në buxhetin e vitit 2026.

Sqaroi se në kuadër të projektit të USAID-it për dëgjimet buxhetore me pjesëmarrje ishin planifikuar 200.000 euro për vitin 2026. Theksoi se këto planifikime nuk janë realizuar, pasi buxheti i vitit 2025 nuk është miratuar. Shpjegoi se komuna ka funksionuar me sistemin 1/12 të buxhetit të vitit 2024, ku këto mjete nuk kanë qenë të përfshira. Tha se kërkesat do të merren parasysh gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2026. Sqaroi se granti nuk është humbur, por problemi ka qenë mosmiratimi i buxhetit të vitit 2025. Njoftoi se Prishtina, Gjilani dhe Zubin Potoku janë tri komunat që nuk kanë pasur buxhet të miratuar për vitin 2025.

Adelina Sahiti - drejtoreshë e Mirëqenies Sociale: - tha se pyetjet për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale erdhën nga organizata Hendikos, me të cilën komuna ka bashkëpunuar ngushtë gjatë viteve të fundit. Theksoi se buxheti për subvencione është rritur nga 800.000 € në 900.000 €, si rezultat i kërkesave për më shumë mbështetje në fushën e mirëqenies sociale. Sqaroi se për shkak të numrit të madh të aplikuesve, asnjë organizatë nuk ka përfituar shumën maksimale të lejuar. Shpjegoi se vlerësimi i aplikimeve është bërë nga një komision i përbërë nga përfaqësues të drejtorisë dhe anëtarë të jashtëm, bazuar në kritere të përcaktuara. Theksoi se komuna ka investuar mbi 50.000 € në përmirësimin e infrastrukturës së Hendikosit, për të përmirësuar kushtet për përfituesit dhe stafin. Sqaroi se investimet infrastrukturore janë marrë parasysh gjatë vlerësimit, me qëllim që të krijohet hapësirë për mbështetjen e organizatave të tjera. Tha se aktualisht mbështeten 44 organizata, me shuma të ndryshme sipas vlerësimit, dokumentacionit dhe numrit të përfituesve. Njoftoi se komuna po kërkon krijimin e një granti specifik dhe zbatimin e kostifikimit të shërbimeve sociale, që do të mundësonte kontraktim të drejtpërdrejtë të shërbimeve. Vlerësoi se ky model do të ishte më efikas dhe do të zvogëlonte pakënaqësitë që krijohen nga sistemi aktual i

subvencioneve. Theksoi se organizatat kanë të drejtë ankese dhe se rastet do të rishqyrtohen nga një komision tjetër, i cili do të marrë vendim në përputhje me rregullat dhe kriteret e vlerësimit.

Gresa Stublla – Qytetare: - theksoi se Hendikosi ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Komunën e Prishtinës dhe Drejtorinë e Mirëqenies Sociale. Shprehu shqetësim se disa organizata kanë përfituar shumë maksimale të grantit 17.000 €, ndërsa gjithashtu marrin edhe forma të tjera mbështetjeje nga komuna, të cilat Hendikosi nuk i përfiton. Tha se Hendikosi vazhdon të mos mbështetet për shpenzimet operative dhe për shërbimet që ofron. Vlerësoi investimet e komunës në infrastrukturën e Hendikosit, por theksoi se ato humbin kuptimin nëse mungon financimi për ofrimin e shërbimeve. Sqaroi se kërkesa për grant është zvogëluar me rreth 6.000 €, gjë që kufizon numrin e fëmijëve që mund të përfitojnë nga shërbimet. Theksoi se Hendikosi Kosova dhe Hendikosi Prishtina janë organizata të ndara, me role dhe shërbime të ndryshme, prandaj nuk duhet të trajtohen njësoj gjatë vlerësimit. Tha se fondet aktuale janë të pamjaftueshme për të mbuluar shërbimet që Hendikosi ofron për fëmijët me aftësi të kufizuara. Rikujtoi se Hendikosi ka kërkuar vazhdimisht institucionalizimin dhe mbështetjen e qëndrueshme të shërbimeve sociale që ofron. Theksoi se këto shërbime janë jetike për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, veçanërisht për familjet me më shumë se një fëmijë me aftësi të kufizuara. Kërkoj sqarime shtesë për procesin e vlerësimit të projekteve dhe për shqyrtimin e ankesës së paraqitur. Vlerësoi rritjen e fondeve krahasuar me vitet e kaluara, por theksoi se ato mbeten ende të pamjaftueshme për nevojat reale të përfituesve.

Gëzim Sveçla – Asamblist: - tha se kërkesat e paraqitura gjatë dëgjimit buxhetor janë të arsyeshme dhe të realizueshme. Tha se arsyetimi për mungesë buxheti nuk qëndron, duke theksuar se Komuna e Prishtinës ka një buxhet prej rreth 161,000,000 euro, me mundësi rritjeje. Kërkoj që projektet të planifikohen edhe në kornizën afatmesme buxhetore, nëse nuk mund të realizohen brenda një viti. Shprehu shqetësim për mënyrën e ndarjes së subvencioneve në të kaluarën, duke thënë se kanë përfituar edhe klube që nuk kanë zhvilluar aktivitetet. Ftoi klubet sportive të denoncojnë rastet e padrejtësive në ndarjen e subvencioneve, në mënyrë që fondet të përfitojnë klubet që i meritojnë. Sqaroi se drejtorët aktualë nuk mbajnë përgjegjësi për subvencionet e ndara më herët, pasi janë emëruar së fundmi. Njoftoi se për subvencionet e fundit në fushën e mirëqenies sociale janë pranuar ankesa, të cilat do të diskutohen në Kuvendin Komunal. Propozoi ndërtimin e dy fushave të reja të futbollit për përdorim nga shkollat e futbollit, duke vlerësuar se komuna ka kapacitete financiare për këtë investim. Theksoi se shumica e stadioneve në Prishtinë janë pronë e komunës dhe jo e klubeve sportive. Kërkoj rishikimin e kontratave për shfrytëzimin e stadioneve dhe rregullimin e statusit të tyre juridik. Sugjeroi që stadiumet komunale të shfrytëzohen nga më shumë se një klub, për të siguruar qasje më të barabartë. Nënvizoi se investimet publike duhet të shërbejnë për interes publik dhe jo vetëm për klube private. Shprehu besim se Drejtoria e Sportit do ta trajtojë këtë çështje duke zgjidhur problemet e pronësisë dhe të shfrytëzimit të stadioneve.

Isah Mustafa – drejtor i Kulturës: - sqaroi se gjatë vitit të kaluar nuk ka pasur thirrje të re për subvencione, pasi procesi është bartur në këtë vit. Tha se thirrja për subvencione është hapur dhe tashmë është mbyllur. Njoftoi se komisioni është duke përfunduar procesin e vlerësimit të aplikimeve. Theksoi se lista përfundimtare e përfituesve pritet të publikohet shumë shpejt, pas përfundimit të punës së komisionit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Dëgjimet publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2027,
20.7.2026

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Hasar	Krasniq	kryetar i klubit		
2	BURIM	BERISHA	QYTETAR		
3	OLTA	BERISHA	NOTARE		
4	Wyskenc	Gozdovci	Sociologe		
5	FATHIR	ZHORELIA	SECRETAR KLUBI		
6	EMIL	BAJRAMI	TRAJNER		
7	ALI	ABETI	TRENER		
8	AGIM	HALIQI	TRENER		
9	LUTKIN	BERISHA	OJQ		
10	Avdullon	Gashi	OJQ		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen! *

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Gëzim		Qytetar		
12	Gëzim	SVEGLA	QYTETAR		
13	BEJULIANA	ABDULLAHU	QYTETAR		
14	Shender	Thaqi	Slika Minuta		
15	Besmir	Radomigi	Oja		
16	Gendresa	Duraku	Studente		
17	Anisa	Bajgora	Studente		
18	Erjona	Brugaj	Studente		
19	Ema	Koxha	studente		
20	Erza	Mehmeti	Studente		
21	Enver	Rademica	asambleist		
22	FLORIN GASHI	GASHI	QYTETARE		
23	GRESA BERISHA	BERISHA	CIVIKOS		
24	JARON KRISTO	KRISTO	CIVIKOS		
25	Alberita	Hylaj	HANDIKOS		
26	GRESA	STUBLLA	HANDIKOS		
27	ARSIM	SPENHATA	AKSAMBLI B.C		
28	EMIN	SAHITI	R.K.A. B. BRAM		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	----------------------

29	NSG	Peshq	K. Loxa		
30	Elza	Comadani	FONDACIONI PER TE DREJTAT E KAPTEVE		
31	ALBIAW	ISMAILI	ORDINER CLUB		
32	INTERVIEWER		KHF PD.		
33					
34					
35					
36					
37					
38					
39					
40					
41					
42					
43					
44					
45					
46					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!